



AVOKATI I POPULLIT

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2  
Tiranë, Shqipëri



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AVOKATI I POPULLIT

Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës,  
trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtërues

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315  
E-mail: [ap@avokatipopullit.gov.al](mailto:ap@avokatipopullit.gov.al)  
[www.avokatipopullit.gov.al](http://www.avokatipopullit.gov.al)

Nr. Prot.  
Nr. Dok. 202100995/2

Tiranë \_\_\_/\_\_\_/2021

**Lënda:** Rekomandim për inspektimin e kryer në Komisaratin e Policisë Gjirokastër.

**Drejtuar:** Kryekomisar Besnik LILA  
Shef i Komisaratis të Policisë

**GJIROKASTËR**

**Për dijëni:** Drejtues i Parë Fatmir HOXHA  
Drejtor i Drejtorisë Vendore të Policisë

**GJIROKASTËR**

*I nderuar z. Lila,*

Mekanizmi Kombëtar për parandalimin e torturës, trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtërues, seksion pranë Avokatit të Popullit, në vijim Mekanizmi Kombëtar (MKPT), bazuar në nenin 19/1 të ligjit nr.8454, datë 04.02.1999, "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar dhe nenin 81 të ligjit nr. 81/2020, "Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve", kreu një inspektim në ambientet e privimit të lirisë të personit në Komisaratin e Policisë Gjirokastër.

Inspektimi u krye në datën 30.06.2021, sipas Planit të Inspektimi të miratuar nga Avokati i Popullit. Në përbërje të grupit inspektues ishin z. Besnik Deda, znj. Gloria Çarkaxhiu dhe z. Hazbi Selita me detyrë nd/komisioner pranë Mekanizmit Kombëtar.

Inspektimi kishte si qëllim verifikimin e respektimit të standardeve të përcaktuara në ligjin nr.108/2014, "Për Policinë e Shtetit", i ndryshuar, procedurën standarde "Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre", miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.925, datë 18.07.2019, procedurën standarde "Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e Policisë së Shtetit", miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.938, datë 24.07.2019, si dhe zbatimin e rekomandimeve të Avokatit të Popullit të bëra gjatë inspektimit të mëparshëm.

Institucioni i Avokatit të Popullit, pasi u njoh me konstatimet e grupit inspektues, ka detyrimin kushtetues dhe ligjor t'ju parashtrorë konkluzionet përfundimtare, si më poshtë vijon:

## Shënime të përgjithshme

Në përputhje me metodologjinë e zhvillimit të inspektimit në institucionet ku mbahen e trajtohen shtetas që iu është privuar liria, grupi i punës u takua me Shefin e Komisarariatit të Policisë Gjirokastër z.Besnik Lila dhe shefin e rendit z.Klaudio Mixha, të cilët u vunë në dijeni lidhur me qëllimin e inspektimit.

Në vijim, shefi i rendit raportoi për grupin e inspektimit, mbi masat e marra për realizimin e rekomandimeve të lëna nga Institucioni i Avokatit të Popullit në inspektimin e mëparshëm, në lidhje me masat e marra për përmirësimin e kushteve në ambientin e shoqërimit dhe të sigurisë, sipas kushteve dhe kriterëve të përcaktuara në procedurat standarde dhe aktet ndërkombëtare për këtë qëllim.

Nga informacioni i drejtuesve të komisarariatit, si dhe nga verifikimi i zbatimit të rekomandimeve të Institucionit të Avokatit të Popullit të vitit të kaluar, rezultoi se:

- **Ishte realizuar** rekomandimi, për instalimin e kamerës në dhomën që shërben për marrjen në pyetje të personave të ndaluar/arrestuar nga specialistët e policisë gjyqësore, me qëllim monitorimin e veprimeve që kryhen me këta persona në ambientin e sigurisë.
- **Ishte realizuar** rekomandimi, për krijimin e një ambienti më vete për marrjen në pyetje për personat e mitur, para se ata të dërgohen në ambientet e sigurisë, i monitoruar me sistemin e kamerave.

Grupi i inspektimit, pasi mori informacionin e nevojshëm lidhur me qëllimin e vizitës inspektuese, vijoi takimin me punonjësin e informacionit dhe përgjegjës të dhomave të sigurisë në Komisarariatit të Policisë Gjirokastër, inspektoi kushtet e mjedisit të shoqërimit dhe të sigurisë, vizitoi zyrat e punës të punonjësve të policisë të cilët kryenin veprime procedurale hetimore me personat e shoqëruar, si dhe u njoh e administroi dokumentacionin ku ishin evidentuar të dhënat dhe veprimet e kryera me personat e shoqëruar dhe të arrestuar/ndaluar, gjatë kohës së qëndrimit në mjediset e këtij komisarariati.

Theksojmë se, drejtuesit dhe punonjësit e policisë të Komisarariatit të Policisë Gjirokastër me të cilët kontaktoi grupi i inspektimit, u treguan bashkëpunues gjatë komunikimit, si dhe inspektimit që u zhvillua në ambientet e këtij institucioni.

Në përfundim grupi monitorues konstatoi se, në Komisarariatit të Policisë Gjirokastër, gjendja e kushteve në mjedisin e shoqërimit dhe të sigurisë, si dhe trajtimi i personave që mbahen dhe qëndrojnë në këto ambiente, sipas kushteve të përcaktuara në nenin 109 të ligjit nr.108/2014, “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, ishin konform akteve ligjore dhe nënligjore, si dhe akteve ndërkombëtare. Por, pavarësisht kësaj, në këtë komisarariat ishin të pranishme dhe disa problematika, si më poshtë vijon:

### Ambientet e shoqërimit dhe kushtet e tyre

Ambienti i shoqërimit në Komisarariatit të Policisë Gjirokastër, ishte i ndërtuar sipas kërkesave të ligjit nr.108/2014, “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar dhe procedurës standarde “Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e Policisë së Shtetit”, miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.938, datë 24.07.2019, ku

parashikohet se dhomat e shoqërimit duhet të jenë me sipërfaqe dhe hapësira të bollshme për qëndrim, si dhe të ndara më vete për femrat, meshkujt madhorë dhe të miturit.<sup>1</sup>

Ambienti shoqërimit ndodhej në katin e parë të godinës së komisariatit dhe përbëhej nga 3 (tre) dhoma shoqërimi, të pajisura me orenditë e nevojshme si karrige për qëndrimin ulur të personave të shoqëruar dhe tavolina pune, me këmbë të fiksuara në dyshe. Përmasat e dhomave ishin 4x3m dhe me kapacitet për qëndrimin ulur deri 3-4 persona për secilën dhomë.

Sipërfaqia dhe hapësira e dhomave të shoqërimit ishin të bollshme për qëndrimin e shtetasve, brenda afatit kohor të 10 orëve, sikurse përcaktohet në aktet ligjore dhe nënligjore. Dhomat e shoqërimit kishin dritare me përmasa të tilla që siguronin ajrim dhe ndriçim të plotë natyral, si dhe kishin ndriçim artificial që furnizohej nga rrjeti elektrik.

Në korridorin e këtij ambienti, ngjitur me dhomat e shoqërimit ishte një tualet për personat meshkuj, ndërsa një tualet tjetër ndodhej brenda në dhomën e shoqërimit për femrat. Ato ishin të pastra nga ana higjeno-sanitare, të pasijura me nyje hidrosanitare dhe kishin ujë të rrjedhshëm.

Korridori i këtij ambienti ishte i monitoruar me sistemin e kamerave. Në korridor dhe brenda në dhomat e shoqërimit ishin të vendosura postera me të drejtat ligjore të personave të shoqëruar në gjuhën shqipe. Ndërsa për shtetasit e huaj, karta e të drejtave ishte përkthyer në disa nga gjuhët e huaja kryesore.

Nga inspektimi u evidentua se, **nuk** kishte dhomë më vete për marrjen në pyetje të personave të shoqëruar dhe intervistimi i tyre kryhej në zyrat e punës të punonjësve të policisë. Ndërsa, për intervistimin/marrjen në pyetje të të miturve që shoqëroheshin në mjediset e komisariatit, ishte krijuar “Njësia për intervistimin e të miturve”, projekt i mbështetur nga UNICEF dhe Qeveria e Norvegjeze, në kuadër të programit “Qasja e fëmijëve në drejtësi 2019 – 2020”.

Nga verifikimi i dokumentacionit, u konstatua se, në këtë komisariat zbatohet detyrimi ligjor i parashikuar në nenin 109/5 dhe 122/5 të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, si dhe në kapitullin VII, pika a.3.4 të procedurave standarde për plotësimin e procesverbalit të veprimeve të kryera me të shoqëruarit nga punonjësit e policisë që ishin ngarkuar me detyrën e kryerjes së verifikimit dhe trajtimit të çështjes përkatëse. Ky dokument plotësohej në dy kopje, një kopje e të cilit mbahej nga punonjësi i policisë në zyrën e informacionit.

Nga verifikimi i disa praktikave të njëpasnjëshme, u evidentuan se, në përfundim të procedurave dhe veprimeve të kryera nga punonjësit e policisë të Komisarariatit, një kopje e procesverbalit pasi firmosej, i jepej edhe personit të shoqëruar.

Nga inspektimi i ambienteve në mjedisin e shoqërimit, nuk u gjetën sende apo mjete të tilla që mund të shërbejnë për kryerjen e vetëvrasjeve të personave apo për kundërveprim ndaj punonjësve të policisë.

---

<sup>1</sup> Kreu VI, pika 3 e procedurës standarde “Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e Policisë së Shtetit”.

Në kohën e inspektimit, nuk kishte asnjë person të shoqëruar në dhomat e shoqërimit të këtij komisariati. Ndërsa për periudhën Janar - Qershor 2021 në regjistër ishin evidentuar të dhënat për 377 persona të shoqëruar në mjediset e këtij komisariati.

Ambienti i shoqërimit ishte i lyster dhe i pastër nga ana higjeno-sanitare.

### **Ambientet e sigurisë dhe kushtet e tyre**

Në Komisarlatin e Policisë Gjrokastër, ambienti i sigurisë ishte i ndërtuar sipas parashikimeve të bëra në ligjin nr.108/2014, *“Për Policinë e Shtetit”*, i ndryshuar dhe procedurës standarde *“Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre”*, miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.925, datë 18.07.2019.

Ambienti i sigurisë ndodhej në katin e parë të ndërtesës së komisarlatit dhe përbëhej nga 8 (tetë) dhoma. Ato ishin të ndara në 6 (gjashtë) dhoma për personat në moshë madhore, 1 (një) dhomë për femrat dhe 1 (një) dhomë për të miturit. Dhomat e sigurisë kishin përmasa 4x4m, të ndara me skarrë hekuri në dy ambiente, dhomë dhe paradhomë. Në secilën dhomë kishte nga një krevat për fjetje dhe vetëm në njërën nga dhomat ishin vendosur 2 krevatë. Kapaciteti i dhomave të sigurisë ishte për 9 (nëntë) persona të ndaluar/arrestuar. Dhomat e sigurisë plotësonin normat dhe parametrat teknikë jetësorë, për një person të arrestuar apo ndaluar, pasi sipërfaqja e përgjithshme ishte jo më pak se 10 metra katrorë, e ndarë në ambient qëndrimi (dhomë) me sipërfaqe 6 m<sup>2</sup> dhe paradhomë me sipërfaqe 4 m<sup>2</sup>.<sup>2</sup>

Dritaret e dhomave mundësonin depërtimin e mjaftueshëm të ajrit dhe dritës natyrale, sikurse kishin edhe ndriçim artificial që furnizohej nga rrjeti elektrik. Brenda ambientit të dhomave të sigurisë kishte tualete dhe çezëm me ujë të rrjedhshëm, për mbajtjen e higjenës personale dhe ambientit të dhomës. Gjithashtu, ato ishin të pajisura me orenditë e nevojshme për jetesë si krevat të fiksuar në dysheme, dyshek, batanije dhe jastëk, të cilat ishin në gjendje të mirë dhe të pastra. Dhomat ishin të lyera dhe të pastra nga ana higjeno-sanitare.

Në çdo dhomë ishin të instaluarat zilet e emergjencës, të cilat mundësonin komunikimin me shërbimin e policisë në rast nevojë. Në korridorin e ambientit të sigurisë kishte aparat telefoni fiks dhe citofon, për t'u përdoruar nga punonjësit e shërbimit në rastet e tentativave apo ngjarjeve të rënda me të ndaluarit/arrestuarit, për të kërkuar ndihmë dhe ndërhyrje të shpejtë. Dhomat e sigurisë kishin edhe burim rezervë energjie me gjenerator.

Në fundin e korridorit, ndodhej një ambient dushi i përbashkët që kishte ujë të ngrohtë dhe shërbente për larjen e trupit. Ndërsa për mbajtjen e higjenës personale, në çdo paradhomë ishin të instaluarat nyjet hidrosanitare, si dhe çezma që furnizoheshin me ujë të rrjedhshëm gjatë 24 orëve.

---

<sup>2</sup>*“Rregullat dhe Proçedurat Standarde për Trajtimin dhe Sigurimin e Personave të Arrestuar dhe Ndaluar në Njësitë Policore”*, miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, Nr.1102, datë 07.11.2017, *“Për trajtimin dhe sigurimin e personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre”*.

Dhomat e sigurisë kishin sistem qëndror për ngrohje/ftohje, i cili ishte funksional.

Ambienti i sigurisë kishte edhe një dhomë për kryerjen e vizitave nga mjeku, e cila ishte e pajisur me krevat, tavolinë dhe karrige. Ajo ishte e pajisur me dollap dhe frigorifer të vogël, për mbajtjen e ilaçeve. Nga inspektimi u evidentua se detyrën e mjekut e kryente kryeinfermieri, i cili ishte në organikë të Drejtorisë Vendore të Policisë Gjirokastrë.

Nisur nga ky konstatim sjellim në vëmendje të DVP Gjirokastrë, se referuar procedurës standarde *“Për trajtimin dhe sigurimin e personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre”*, kapitulli V, pika 7, parashikohet se kontrolli mjekësor i të arrestuarve/ndaluarve bëhet nga mjeku apo ndihmësmjeku i drejtorisë/komisariatit. Në këto kushte, ne gjykojmë se një punonjës që ka kryer shkollimin për infermier nuk mund të kryejë detyrën e mjekut apo ndihmësmjekut, si për konstatimin e problemeve shëndetësore që mund të kenë të arrestuarit/ndaluarit ashtu edhe për trajtimin e tyre me profesionalizëm dhe dhënien e ndihmës apo të medikamenteve mjekësore përkatëse. Për më tepër, sistemi i lartë universitar në vendin tone, aktualisht nuk ka shkollë për përgatitjen e ndihmësmjekëve, por të “Mjekëve” dhe “Infermierëve”.

Sa më sipër, është i nevojshëm të bëhet propozimi nga ana juaj drejtuar DPSH Tiranë, për ndryshim të strukturës dhe organikës në DVP Gjirokastrë, ose për ndryshimin e emërimit të punonjësit të shëndetësisë që kryen detyrën e mjekut, sipas standardeve të miratuara për këtë qëllim. Nisur nga gjetjet në inspektimet e mëparshme, por edhe nga konstatimi në inspektimin e Komisarariatit të Policisë Gjirokastrë, sjellimi në vëmendjen tuaj se Avokati i Popullit i ka rekomanduar Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, marrjen e masave të menjëhershme organizative për zëvendësimin e pozicionit të kryeinfermierit në DVP/Komisariatet në shkallë vendi me mjekë me kohë të plotë pune, sikurse parashikohet në kapitullin V, pika 7, të procedurës standarde të cituar më sipër, si dhe ndryshimin e emërimit dhe zëvendësimin e pozicionit në organikë të “ndihmësmjekut” me atë të “kryeinfermierit”<sup>3</sup>.

Nga inspektimi, u konstatua se brenda ambientit të sigurisë ndodhej dhoma për takimin e të ndaluar/arrestuarve me avokatët mbrojtës, e cila shërbente njëkohësisht dhe si dhomë për marrjen në pyetje nga përfaqësuesi i organit të akuzës, e cila ishte e monitoruar me sistemin e kamerave, për mbajtjen në vëzhgim të veprimeve që kryhen me këta persona. Kjo dhomë ishte e pajisur me tavolinë pune për oficerët e policisë gjyqësore dhe karrige me këmbë të fiksuara në dysheme, për qëndrimin ulur të personave të ndaluar/arrestuar dhe punonjësve të policisë gjyqësore.

Hyrja kryesore e ambientit të sigurisë, korridori i tij dhe hyrjet në dhomat e sigurisë monitoroheshin nga sistemi audio-viziv me kamera. Në ambientin e sigurisë ishin të instaluar 4 kamera për mbajtjen në vëzhgim përgjatë 24 orëve. Sistemi i kamerave administrohej nga specialisti i IT në DVP Gjirokastrë dhe filmimet ruheshin deri në 15 ditë.

Në momentin e inspektimit, në ambientin e sigurisë nuk ndodhej asnjë person i arrestuar/ndaluar. Ndërkohë, nga verifikimi i regjistrit ku evidentoheshin të dhënat e personave të ndaluar/arrestuar, për periudhën Janar-Qershor 2021 ishin mbajtur dhe

---

<sup>3</sup> Rekomandim me nr.doc. 201800959/4, viti 2018, drejtuar Drejtorit të Policisë së Shtetit.

siguruar në total 65 persona, nga të cilët 3 femra, 1 i mitur, 2 shtetas të huaj (Bangladeshi) dhe 59 persona në moshë të rritur. Sipas shënimeve në regjistër dhe statistikat e periudhës 6-mujore, nuk rezultoi në asnjë periudhë të ketë patur situata mbipopullimi në dhomat e sigurisë.

Trajtimi me ushqim i personave të arrestuar/ndaluar kryhej 3 (tre) herë në ditë, sipas normave për trajtimin me ushqim të përcaktuar në VKM nr.189, datë 15.03.2017 *“Për trajtimin me ushqim të punonjësve, të studentëve dhe të kursantëve në institucionet arsimore të Policisë së Shtetit, si dhe të shtetasve të ndaluar dhe arrestuar deri në sqarimin e pozitës së tyre”*. Ushqimi përgatitej nga një subjekt privat në bazë të kontratës së lidhur me institucionin dhe ofrohej me shërbim katering.

Ndonëse në ambientet e sigurisë nuk kishte ambiente kulti, të ndaluarve/arrestuarve që dëshironin u lejohej ushtrimi i riteve fetare brenda dhomave të sigurisë.

Nga informacioni i dhënë nga përgjegjësi i dhomave të sigurisë, rezultoi se, të ndaluar/arrestuarve u jepeshin produkte për ruajtjen e higjienës vetjake dhe mbajtjen pastër të dhomave të sigurisë si sapun, detergjente, letra higjienike dhe letra për fshirjen e duarve dhe të fytyrës. Këto produkte mbaheshin dhe administroheshin nga përgjegjësi i dhomave të sigurisë.

Nga verifikimi i regjistrit të kërkesë/ankesave, nuk rezultoi të kishte raste apo pretendime për trajtim denigrues, jo human apo për ushtrim dhune fizike e psikologjike, nga punonjësit e policisë të komisariatit. Për vitin 2021 ishin regjistruar vetëm 6 ankesa me objekt, takime për avokatë apo njoftim të familjarëve.

Nga informacioni i drejtuesve të komisariatit, rezultoi se, personave që ju ishte komunikuar masa e sigurisë “arrest me burg”, kishin dijeni për identitetin e punonjësit të policisë me të cilin kishin marrë kontakt dhe kishin kryer veprimet procedurale. Gjithashtu, gjatë shoqërimit apo ndalimit/arrestimit të shtetasve në konflikt me ligjin për në mjediset e policisë, punonjësit e policisë që kishin kontaktuar me ta, ishin identifikuar përpara tyre duke u prezantuar me gjeneralitetet dhe detyrën që kryenin.

Në përfundim të veprimeve procedurale me personat e ndaluar/arrestuar, oficerët e policisë gjyqësore ju jepnin kopje të procesverbalit të ndalimit/arrestimit, procesverbalit të kontrollit personal dhe kopje të kartës me të drejtat e tyre.

Nga informacionet e grumbulluara gjatë vizitës nuk rezultoi asnjë rast i përdorimit të mjeteve të forcës dhe shtrëngimit fizik, si dhe asnjë rast i përdorimit të armëve të zjarrit nga ana e policisë ndaj shtetasve të ndaluar/ arrestuar, me qëllim përmbushjen e një synimi të ligjshëm sipas dispozitave ligjore në fuqi.

### **Regjistri i personave të shoqëruar, ndaluar/arrestuar dhe evidentimi i tyre**

Në zbatim të kërkesave të ligjit nr.108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, si dhe procedurave standarde *“Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e Policisë së Shtetit”*<sup>4</sup> dhe *“Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së*

---

<sup>4</sup> *Kreu VII, pika 5*

*Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre*<sup>5</sup>, parashikohet se çdo njësi policore që ka dhoma shoqërimi dhe sigurie, duhet të jetë e pajisur ndër të tjera edhe me regjistrat përkatës.

Gjatë kontrollit të dokumentacionit, u evidentua se, Komisariati i Policisë Gjirokastrë, ishte i plotësuar me regjistrat e përcaktuar sipas inventarit të procedurave standarde. Ato mbaheshin në dhomën e përgjegjës të dhomave të sigurisë dhe në zyrën e informacionit. Administrimi dhe plotësimi i tyre kryhej nga punonjësit e policisë të ngarkuar me këtë detyrë. Regjistrat ishin të sekretuar dhe të plotësuar sipas rubrikave.

Nga verifikimi, “Regjistri i evidentimit të të dhënave për personat e shoqëruar” ishte i tipit “Model nr.1” sipas procedurave standarde “Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e Policisë së Shtetit”, i cili mbahej në zyrën e informacionit dhe ishte i sekretuar e i plotësuar sipas rubrikave.

Të gjithë personat e shoqëruar në organin e policisë sipas dispozitave të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, regjistroheshin në këtë regjistër nga punonjësit e zyrës së informacionit.

Nga kqyrja e këtij regjistri rezultoi se, koha e qëndrimit në gjendje shoqërimi e shtetasve ishte e ndryshme nga 1 deri në 10 orë në raste të veçanta. Rubrikat e regjistrit ishin plotësuar në mënyrë korrekte, me përgjegjësi dhe saktësi nga punonjësit e policisë në zyrën e informacionit<sup>6</sup>.

Gjithashtu, në këtë komisariat ishte vendosur regjistri për personat e ndaluar/arrestuar, ku evidentoheshin të gjitha rastet e ndalimeve dhe arrestimeve të kryera nga punonjësit e policisë së këtij komisariati.

Nga kqyrja e regjistrit rezultoi se, në rastet e arrestimeve në flagrancë, ora e arrestimit e shënuar në procesverbalin e arrestimit, përputhej me orën e shoqërimit të tyre në momentin e hyrjes në mjedisin e komisariatit të policisë.

Nga inspektimi rezultoi se, mungonte regjistri i posaçëm për evidentimin e të dhënave të të miturve në konflikt me ligjin, sipas rekomandimit të Institucionit të Avokatit të Popullit<sup>7</sup>.

Ndërkohë, në zbatim të kërkesave të nenit 115 të ligjit nr.108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, komisariati kishte edhe regjistër për evidentimin e kërkesë/ankesave të personave të shoqëruar, të arrestuar dhe të ndaluar. Për periudhën Janar - Qershor 2021 ishin evidentuar 6 kërkesa nga ana e personave të arrestuar/ndaluar me objekt për njoftimin e familjeve dhe pajisjen me avokat mbrojtës nga lista e miratuar nga organi i prokurorisë, kërkesa që sipas shënimeve në regjistër, ishin të plotësuara nga punonjësit e shërbimit në dhomat e sigurisë.

## **Ambientet e intervistimit**

---

<sup>5</sup> *Kreu XI, pika 1*

<sup>6</sup> *Kreu VII, procedurat standarde “Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e Policisë së Shtetit”.*

<sup>7</sup> *Rekomandim nr.437 prot., datë 11.10.2019 drejtuar Ministrisë së Brendshme, Ministrisë së Drejtësisë dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit.*

Në Komisarlatin e Policisë Gjyrokastër specialistët e policisë gjyqësore i kryenin veprimet proceduriale me shtetasit në zyrat e punës, pasi nuk kishte një ambient të veçantë për intervistimin/marrjen në pyetje të shtetasve, që të jetë i monitoruar me kamera.

Ndërsa, në ambientet e sigurisë të komisarlatit kishte një dhomë për marrjen në pyetje të shtetasve të ndaluar/arrestuar nga përfaqësuesit e akuzës, e cila shërbente njëkohësisht dhe për takim me avokatët mbrojtës, ku ishin instaluar kamera për vëzhgimin e veprimeve që kryhen me këta shtetas.

Në lidhje me intervistimin/marrjen në pyetje të persona të mitur, sikurse e përmendëm edhe më lart, ishte krijuar një ambient më vete, brenda godinës të komisarlatit. Ky ambient përbëhej nga 4 dhoma të ndara më vete, të pajisura me orenditë e nevojshme për qëndrimin ulur të të miturve, kujdestarit ligjor dhe avokatit mbrojtës, si dhe me orenditë për punën që kryejnë specialistët e policisë. Stafi i policisë që punonte në “Njësinë për intervistimin e të miturve”, përbëhej nga 2 specialistë policie dhe ishin të trajnuar për këtë qëllim.

Nga monitorimi që u bë në disa prej zyrave të punonjësve të policisë në godinën aktuale të Komisarlatit të Policisë Gjyrokastër, nuk u gjetën sende, prania e të cilave të ekspozonte dhunë tek personat me të cilët ata kryenin veprime proceduriale.

### **Ndihma juridike, psikologjike dhe kujdesi mjekësor**

Sipas informacionit dhe nga intervistimi i punonjësit të policisë në zyrën e informacionit, rezultoi se zbatohet detyrimi ligjor i parashikuar në nenin 109/5 dhe 122/5 të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, si dhe në kapitullin VII, pika a.3.4 të procedurave standarde, për plotësimin dhe dhënien çdo personi të shoqëruar, të kopjes së procesverbalit mbi veprimet e kryera me të shoqëruarit nga punonjësit e policisë që ishin ngarkuar me detyrën e kryerjes së verifikimit dhe trajtimin e çështjes përkatëse.

Nga inspektimi u evidentua se, fashikulli që ndodhej në zyrën e informacionit, përbëhej nga procesverbal tip i emërtuar “Formulari i raportit të Shoqërimit ose Ndalimit/Arrestimit”, si dhe procerverbali i shoqërimit, të plotësuar sipas rubrikave, të cilët ishin të firmosur nga punonjësi i policisë që kishte trajtuar çështjen dhe personi i shoqëruar. Gjithashtu, personat e shoqëruar në mjediset e policisë pajiseshin me letrën e të drejtave, që në momentin e hyrjes në ambientet e komisarlatit.

Për personat e ndaluar/arrestuar, zbatohet detyrimi ligjor i parashikuar në nenet 34/b pika 2 dhe 251 të K.Pr.P, ku thuhet se të ndaluarit/arrestuarit duhet t’i jepet dhe të mbajë me vete një kopje të letrës me të drejtat që gëzojnë këta persona dhe kopje të procesverbalit të ndalimit/arrestimit.

Në takimin që grupi i inspektimit zhvilloi me punonjësit e shërbimit në dhomat e sigurisë, rezultoi se, zbatohet detyrimi ligjor për të informuar personat e ndaluar/arrestuar në moshë madhore se, në mungesë të mundësive financiare për të pajtuar një avokat mbrojtës, mund të kërkojë ndihmë juridike dhe ti ofrohet një Avokat mbrojtës kryesisht nga lista e avokatëve të dërguar nga organi i prokurorisë, e cila ishte e afishuar në zyrën e përgjegjësit të dhomave të sigurisë.

Gjithashtu, në lidhje me trajtimin e personave në momentin që hyjnë në komisarlatet e policisë, sjellim në vëmendje nevojën e verifikimit të gjendjes fizike të personave, për të



mënjëherë përgjegjësinë e autoriteteve të policisë, për çështjet e dhunës, sipas rekomandimit edhe të Komitetit Evropian për Parandalimin e Torturës, Trajtimin ose Dënimin Çnjerëzor ose Poshtëruar (CPT), i cili në raportin për Shqipërinë të botuar në vitin 2019, midis të tjerave ka cituar se: *“Oficerët e policisë duhet të trajtohen që të mos përdorin forcë më shumë sesa është e nevojshme dhe se ajo mund të përdoret vetëm në rast të kapjes së një personi. Pasi ai është arrestuar dhe mbahet nën kontroll, nuk mund të ketë asnjë justifikim për goditjen e tij. Kur vlerësohet e nevojshme të prangoset një person, prangat në asnjë rrethanë nuk duhet të jenë tepër të shtrënguara dhe duhet të mbahen për aq kohë sa është e nevojshme”*<sup>8</sup>.

Në lidhje me shtetasit e ndaluar/arrestuar të huaj, për të garantuar të drejtat e tyre, ishte përkthyer letra me të drejtat në disa gjuhë të huaja, si anglisht, spanjisht, frëngjisht, italisht, greqisht, gjermanisht, maqedonisht, serbisht, sllovenisht dhe gjuhën rome.

Në rastet kur të ndaluarit/arrestuarit ishin të mitur, veprimet procedurale kryheshin në praninë e detyrueshme të avokatit mbrojtës të caktuar kryesisht, kujdestarit ligjor dhe të psikologut që ishte në organikë të DVP Gjirokastër. Në raste të veçanta, psikologu sigurohej edhe në bashkëpunim me shkollat e mesme të qytetit të Gjirokastrës.

Nga verifikimi i regjistrit ku pasqyrohen vizitat mjekësore që kryen personeli mjekësor me personat e ndaluar/arrestuar, rezultoi se ato kryheshin brenda afatit 12 orë nga momenti i hyrjes të këtyre personave në ambientin e sigurisë. Vizitat mjekësore kryheshin nga infermieri, në mungesë të mjekut, sikurse e përmendëm edhe më lart.

Ndërsa, në rastin e urgjencave apo vizitave mjekësore te mjekët specialist, njoftohej menjëherë nga përgjegjësi i dhomave të sigurisë urgjenca e spitalit dhe në bazë të rekomandimit të mjekut të urgjencës, personat e ndaluar/arrestuar shoqëroheshin për në Spitalin Rajonal Gjirokastër. Rezultat e kontrollit mjekësor pasqyroheshin në regjistrin e vizitave mjekësore. Ndërkohë, për çdo person të ndaluar/arrestuar ishin hapur kartelat mjekësore (kartelat ditore) të tyre, të cilat vendoseshin në fashikullin përkatës të secilit prej tyre dhe administroheshin nga përgjegjësi i dhomave të sigurisë.

Për sa më sipër dhe në mbështetje të pikës 3, të nenit, 63 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ku thuhet se: *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike”*; të nenit 21, germa “b” të ligjit nr. 8454 dt. 04.02.1999 *“Për Avokatin e Popullit”*, i ndryshuar, ku thuhet se: *“Avokati i Popullit paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive; si dhe në bazë të nenit 81, pika 2/b të ligjit Nr. 81/2020 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”*, ku parashikohet midis të tjerash se: *“Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës ka këto kompetenca: b) paraqet rekomandime për organet përkatëse, me qëllim që të përmirësohen trajtimi dhe kushtet e individëve që u është hequr liria dhe të parandalohet tortura, trajtimi ose dënimi i egër, çnjerëzor ose poshtëruar.”*

## REKOMANDOJMË:

<sup>8</sup> CPT ka bërë publik në datën 17.09.2019, raportin mbi vizitat që ka kryer në disa institucione të privimit të lirisë në Shqipëri, nga data 20 deri në datën 30 Nëntor 2018. <https://www.coe.int/en/web/cpt/-/council-of-europe-anti-torture-committee-publishes-report-on-alban-3>

1. Marrjen e masave të menjëhershme, për vendosjen në zyrën e informacionit të regjistrit për evidentimin e të dhënave të të miturve që shoqërohen në mjediset e Komisarariatit të Policisë Gjirokastrë.
2. Marrjen e masave të menjëhershme organizative, për zëvendësimin e pozicionit të kryeinfermierit në Komisarariatit të Policisë Gjirokastrë, me mjekë me kohë të plotë pune, sikurse parashikohet në kapitullin V, pika 7 të procedurës standarde ose ndryshimin në strukturën/organikën e miratuar të kësaj drejtorie, të emërtimit “ndihmësmjek” me fjalën “infermier”.
3. Marrjen e masave të nevojshme, për intervistimin/marrjen në pyetje të personave të shoqëruar në një dhome më vete brenda ambientit të shoqërimit dhe jo në zyrat e punës të punonjësve të policisë.

Për qëndrimin dhe masat që do merrni në zbatim të këtij rekomandimi, të vihemi në dijeni brenda afatit 30 ditor sipas nenit 22 të ligjit nr.8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar.

*Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,*

**KOMISIONER**

**Ermonela XHAFA**